



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 15.11.2017

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

### R A P O R T

#### PËR VLERËSIMIN NË PARIM TË PROJEKTLIGJIT

#### “PËR BUXHETIN E VITIT 2018”

#### **I. Hyrje.**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në 9 mbledhje, të zhvilluara në datat 1, 3, 6, 7, 8, 10, 13, 14 e 15 nëntor 2017, shqyrtoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2018”, propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Projektbuxheti, si çdo vit, u shqyrtua sipas një kalendari të posaçëm pune, të koordinuar me komisionet e tjera të Kuvendit. Ministri i Financave, i cili ishte i pranishëm në të gjitha mbledhjet e Komisionit, paraqiti disa prezantime për projektbuxhetin në tërësi dhe pjesët e veçanta të tij, si dhe iu përgjigj pyetjeve të deputetëve.

Komisioni shqyrtoi politikat dhe treguesit e përgjithshëm të projektbuxhetit, si dhe analizoi në detaj pjesët e veçanta të tij, si të ardhurat, shpenzimet, defiçitin buxhetor e borxhin publik. Në mbledhje të posaçme Komisioni shqyrtoi investimet dhe veprimtaritë në fushën e koncesioneve e partneritetit publik privat, si dhe efektet e tyre në ekonomi. Shqyrtimi në parim i projektbuxhetit u koordinua me shqyrtimin në parim të projektligjeve të paketës fiskale, për shkak të efekteve financiare përkatëse.

#### **II. Baza ligjore.**

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2018” është propozuar nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në:

- Nenet 158 dhe 159 të Kushtetutës;
- Nenin 29 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”.

Shqyrtimi i këtij projektligji bëhet sipas procedurave të përcaktuara në nenet 78-84 të Rregullores së Kuvendit.

Është viti i katërt që projektbuxheti vjetor paraqitet si pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm, duke përcaktuar dhe harmonizuar politikat dhe treguesit për vitin e ardhshëm me ato të viteve 2019 dhe 2020, për të siguruar përshpejtimin e ritmeve të rritjes ekonomike dhe forcimin e stabilitetit makroekonomik të vendit në periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

Politikat dhe treguesit e projektbuxhetit mbështeten në trendin e zhvillimit të ekonomisë së vendit në vite, zhvillimet ekonomike të deritanishme dhe ato të pritshme për vitin 2017, si dhe pritshmëritë për zhvillimin afatmesëm.

### **III. Opinioni i Bankës së Shqipërisë për projektbuxhetin.**

Në datën 15 nëntor 2017, Komisioni për Ekonominë dhe Financat zhvilloi një seancë dëgjimore me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, për të marrë opinionin e institucionit që ai drejton për projektbuxhetin. Guvernatori analizoi kahun dhe efektin e politikës fiskale në ekonomi, qëndrueshmërinë afatgjatë të financave publike, huamarrjen publike dhe ndikimin e saj në tregjet e brendshme financiare, si dhe dha disa rekomandime për rritjen e efektivitetit e të qëndrueshmërisë së financave publike.

Në fjalën e tij, Guvernatori theksoi se ekonomia shqiptare është në një trend pozitiv zhvillimi. Aktiviteti ekonomik i vendit po vjen në rritje, bilancet financiare të sektorit publik dhe privat janë drejt përmirësimit, ekuilibrat e brendshëm dhe të jashtëm po vijnë drejt shëndoshjes, ndërsa besimi i agjentëve privatë është drejt konsolidimit.

Kjo ecuri është favorizuar nga politikat e brendshme ekonomike, si politika monetare stimuluese, konsolidimi fiskal dhe politika e kujdesshme makroprudenciale. Ndikim pozitiv ka dhënë edhe përmirësimi i ambientit të jashtëm.

Premisat e zhvillimit të vendit mbeten pozitive. Nëpërmjet shënjestrimit të një balance primare pozitive dhe synimit për reduktimin e mëtejshëm të borxhit publik, projektbuxheti i vitit 2018 vazhdon rrugën e konsolidimit fiskal. Projektbuxheti ruan të pandryshuar kombinimin e politikave ekonomike që kanë mbështetur zhvillimin e vendit, çka ndihmon në forcimin e mëtejshëm të ekuilibrave makroekonomikë, rrit besimin e investitorëve në ekonominë shqiptare, si dhe dërgon sinjalet e duhura në tregjet financiare dhe në agjencitë e renditjes së borxhit publik.

Projeksionet e të ardhurave fiskale duken të kujdesshme, ndërsa politika e shpenzimeve publike dhe politika tatimore duken konsistente me zhvillimet e pritura ekonomike. Kompozimi i shpenzimeve publike paraqitet mbështetës për zhvillimin e vendit. Shpenzimet kapitale parashikohet të rriten me ritme më të shpejta se shpenzimet korrente gjatë vitit 2018, duke arritur në nivelin 5.2% të PBB-së. Buxheti i vitit 2018 parashikon rritjen e të ardhurave tatimore, kryesisht në linjë me përmirësimin e aktivitetit ekonomik, por pjesërisht edhe si rrjedhojë e rritjes së formalizimit të ekonomisë. Efekti fiskal i vlerësuar i ndryshimeve në legjislacionin tatimor e doganor duket të jetë i vogël. Duke u bazuar në këto vlerësime, ndikimi i pritur i masave fiskale në inflacion pritet të jetë relativisht i ulët dhe kalimtar.

Projektbuxheti i vitit 2018 plotëson kërkesat që burojnë nga ligji organik i buxhetit, duke ndihmuar disiplinimin e hartimit dhe zbatimit të politikave fiskale, rritjen e konsistencës së tyre në vite dhe forcimin e financave publike në periudhën afatgjatë. Gjithashtu, ai redukton primet e rrezikut dhe përmirëson klimën e investimeve në vend.

Projektbuxheti i vitit 2018 prezanton vendosjen e një kufiri mbi vlerën totale të projekteve të kontraktuara në kuadrin e programit të partneritetit publik privat, në nivelin 40.1% të PBB-së.

Banka e Shqipërisë vlerëson pozitivisht vendosjen e këtij kufizimi, pasi ai ndihmon në parandalimin e zgjerimit të paplanifikuar të detyrimeve publike.

Në përfundim, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dha disa rekomandime për strukturën e financimit të borxhit publik, monitorimin e skemave të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe forcimin e monitorimit të programeve të partneritetit publik privat.

#### **IV. Vlerësimi i Komisionit për projektbuxhetin.**

##### **IV.1. Vlerësimi i mazhorancës.**

Mazhoranca në Komision e vlerësoi pozitivisht projektbuxhetin, duke vënë theksin në disa karakteristika kryesore të tij, si më poshtë:

##### **1. Projektbuxheti është në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator.**

Politikat, treguesit dhe objektivat e projektbuxhetit mbështeten në:

- Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020;
- Kuadrin makroekonomik e fiskal afatmesëm 2018-2020;
- Programin e Qeverisë;
- Politikat dhe prioritetet e zhvillimit të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë;
- Ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe aktet nënligjore përkatëse etj.

##### **2. Projektbuxheti është në përputhje me rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare.**

Politikat dhe treguesit kryesorë të projektbuxhetit mbështeten në vlerësimet dhe rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare, si Komisioni European, FMN, Banka Botërore, etj. Opinioni i përgjithshëm i këtyre institucioneve, i paraqitur në raportimet periodike përkatëse, është që ekonomia e Shqipërisë është rritur dhe vazhdon të forcohet, mbështetur nga rritja e konsumit privat, investimet e huaja direkte të mëdha të lidhura me sektorin e energjisë, përmirësimi i sektorit të turizmit dhe një rimëkëmbje e ekonomive të partnerëve kryesorë tregtarë të BE-së. Shqipëria parashikohet me një perspektivë pozitive të rritjes ekonomike dhe me një nivel inflacioni që, deri në fund të vitit 2022, pritet të arrijë plotësisht objektivin e Bankës së Shqipërisë. Krahasuar me ekonomitë në zhvillim, situata e rritjes ekonomike dhe nivelit mesatar të inflacionit për Shqipërinë tregon një perspektivë tejet pozitive për periudhën afatmesme. Rritja ekonomike ndikoi në rritjen e punësimit. Situata fiskale vazhdoi të përmirësohet me të ardhura më të larta dhe shpenzime të kontrolluara. Këto institucione kanë dhënë një sërë rekomandimesh për të siguruar përsheptimin e rritjes ekonomike dhe forcimin e konsolidimit fikal në periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

##### **3. Projektbuxheti ka pikënisje arritjet e ekonomisë së vendit gjatë vitit 2017.**

Gjatë vitit 2017, ekonomia e vendit vijoi tendencën e përsheptimit të rritjes ekonomike, e cila nga 1 për qind në vitin 2013; 1.8 për qind në vitin 2014; 2.2 për qind në vitin 2015; 3.4 për qind në vitin 2016; pritet të jetë 3.9 për qind në vitin 2017. Kjo rritje është gjeneruar nga rritja e kërkesës së brendshme, si rezultat i rritjes së konsumit dhe ritmeve të larta të investimeve publike. Investimet publike u rritën nga 4 për qind e PBB në vitin 2016; në 4.8 për qind të PBB në vitin 2017. Investimet e huaja direkte u rritën me 8.5 për qind krahasuar me një vit më parë. Ndikim pozitiv pati edhe rritja e kërkesës së huaj, e cila u shpreh nëpërmjet rritjes së eksportit të mallrave e shërbimeve.

Nga ana e ofertës, kontributin kryesor në rritjen ekonomike e dhanë ndërtimi; aktivitetet financiare dhe të sigurimit; industria; administrata publike dhe mbrojtja; arsimi dhe shëndetësia.

Rritja ekonomike dha efektin e vet në rritjen e punësimit. Numri i të punësuarve të moshës 15-64 vjeç u rrit me 3.4 për qind, ndërsa norma e papunësisë u reduktua nga 15.6 për qind, në 14.1 për qind.

Rritja e treguesit të ndjesisë ekonomike reflektoi përmirësimin e besimit të bizneseve të tregtisë dhe ndërtimit, si dhe besimit të konsumatorëve.

Zhvillime pozitive pati edhe në treguesit fiskalë, ku vërehet se në krahasim me një vit më parë:

- Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit vlerësohet të rriten me rreth 31 miliardë lekë ose 7.7 pikë përqindje. Impaktin kryesor në këtë rritje e dha rritja e të ardhurave nga tatimet dhe doganat, duke reflektuar përshpejtimin e ativitetit ekonomik dhe përmirësimin e administrimit në mbledhjen e të ardhurave.
- Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit u rritën me afro 36 miliardë lekë ose 8.3 pikë përqindje. Impakt të rëndësishëm në këtë rritje e dha rritja e shpenzimeve kapitale me 24.6 pikë përqindje.
- Defiçiti buxhetor vlerësohet të arrijë nivelin 2 për qind të PBB. Viti 2017 është viti i dytë kur bilanci primar u rikthye nga terreni negativ, në atë pozitiv, duke arritur nivelin 0.4 për qind të PBB.
- Borxhi publik vlerësohet të reduktohet nga 72.4 për qind e PBB në vitin 2016, në 71.5 për qind të PBB në vitin 2017.

Politika fiskale konsoliduese ndikoi në uljen e primeve të rrezikut dhe rritjen e hapësirave për financimin e sektorit privat. Këta faktorë do të vazhdojnë të ndihmojnë rritjen ekonomike, kthimin e ekonomisë në ekuilibër dhe të inflacionit në objektiv.

Ecuria pozitive e aktivitetit ekonomik në vend mbështetet nga politika monetare stimuluese, e cila ruan një mjedis financiar me norma të ulëta interesi dhe me likuiditet të bollshëm.

#### **4. Projektbuxheti parashikon përmirësim të mëtëjshëm të rritjes ekonomike në periudhën afatmesme.**

Ekonomia e vendit pritet të përmirësohet më tej në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike pritet të përshpejtohet në mënyrë të qëndrueshme dhe vlerësohet që në vitin 2018 të jetë 4.2 për qind, në vitin 2019 të jetë 4.3 për qind dhe në vitin 2020 të jetë 4.4 për qind. Gjeneratorët kryesorë të rritjes ekonomike parashikohet të jenë investimet, veçanërisht investimet e huaja direkte dhe konsumi. Performancë pozitive parashikohet të ketë edhe eksporti i shërbimeve, veçanërisht i shërbimeve turistike, i cili parashikohet të rritet me 8.9 për qind në vitin 2018. Edhe kërkesa e huaj neto parashikohet të japë kontribut pozitiv gjatë vitit 2018 dhe periudhës afatmesme.

#### **5. Investimet publike do të vijojnë të jenë ndër faktori kryesor i rritjes ekonomike.**

Një ndër prioritetet e projektbuxhetit është rritja e investimeve publike, të cilat kanë një ndikim të konsiderueshëm në rritjen e kërkesës agregate në periudhën afatshkurtër dhe rritjen ekonomike në periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Për këtë arsye, për vitin 2018 parashikohet që investimet publike të jenë në nivelin 5.2 për qind të PBB, e cila përbën rritjen më të lartë të viteve të fundit. Rritja e investimeve do të mbështesë rritjen e kapitalit fiks bruto në ekonomi, i cili luan një rol të rëndësishëm për të mbajtur norma të larta të rritjes ekonomike si në periudhën afatshkurtër, ashtu

edhe atë afatgjatë. Kjo do të ndodhë ndërsa borxhi publik do të vazhdojë trajektoren rënëse, duke zbritur me 2 për qind deri në fund të vitit të ardhshëm.

## **6. Tipari kryesor i projektbuxhetit dhe PBA vijon të jetë thellimi i konsolidimit fiskal.**

Politika fiskale do të vijojë të jetë konsoliduese, për të siguruar uljen e primeve të rrezikut dhe rritjen e hapësirave për financimin e sektorit privat.

***Defiçiti buxhetor*** për vitin 2018 parashikohet të jetë 2 për qind e PBB dhe do të reduktohet më tej vitet e ardhshme, duke arritur nivelin 1.2 për qind të PBB në vitin 2020. Bilanci primar parashikohet të përmirësohet më tej, duke arritur nivelin 0.6 për qind të PBB në vitin 2018 dhe duke u rritur më tej, deri në 1.5 për qind të PBB në vitin 2020.

***Borxhi publik*** parashikohet të reduktohet më tej, duke vënë në zbatim një ndër politikat kryesore të përcaktuara në strategjinë për reduktimin e borxhit publik dhe një ndër rekomandimet kryesore të institucioneve financiare ndërkombëtare, që synon rritjen e qëndrueshmërinë fiskale të ekonomisë sonë. Niveli i tij parashikohet të zbresë në 68.7 për qind të PBB në vitin 2018 dhe do të reduktohet më tej vitet e ardhshme, duke arritur nivelin 63.5 për qind të PBB në vitin 2020.

## **7. Projektbuxheti materializon parimet dhe rregullat fiskale, të përcaktuara në ligjin organik të buxhetit.**

Treguesit e projektbuxhetit respektojnë parimet dhe rregullat fiskale, të përcaktuara në nenin 4/1 të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, të rishikuar, si më poshtë:

- Në projektbuxhetin për vitin 2018 dhe për çdo vit të PBA raporti i borxhit publik ndaj PBB është parashikuar me ulje kundrejt vitit pararendës.
- Vlera e PBB nominale në lekë është e njëjtë (jo më e lartë) me verën respektive të parashikuar në Raportin “Perspektiva ekonomike botërore” të FMN, publikuar në tetor 2017.
- Projektbuxheti përfshin një kontigjencë prej 4 miliardë lekësh ose 0.8 për qind të shpenzimeve të përgjithshme për të përballuar impaktin në borxhin publik nga luhatjet e mundshme të normave të interesit mbi alokimet respektive në buxhet.
- Projektbuxheti nuk përfshin të ardhura nga privatizimet e mundshme. Në rast të arkëtimit, ato do të përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike.
- Masa e defiçitit buxhetor për vitin 2018 është 56 për qind më e ulët se shpenzimet kapitale ose 62 për qind më e ulët se shpenzimet kapitale të qeverisjes qendrore, plus fondet e alokuara për FZHR dhe për kredi direkte për investime në sektorin e energjisë elektrike.

Respektimi i këtyre rregullave ka impakt të rëndësishëm në ruajtjen e qëndrueshmërisë së borxhit publik.

## **8. Projektbuxheti mbështet vijimin dhe thellimin e reformave në sektorët kryesorë të ekonomisë.**

Projektbuxheti parashikon fondet e nevojshme për realizimin e të gjitha reformave të nisura vitet e fundit, siç janë:

### **Reforma në sektorin e ujit.**

Reforma në sektorin e ujit do të fokusohet në miradministrimin e burimeve ujore, rritjen e mbulimit të furnizimit me ujë të pijshëm, rritjen e numrit të orëve të shërbimit, reduktimin e humbjeve fizike në rrjet, rikuperimin e kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes, qëndrueshmërinë financiare të ndërmarrjeve dhe ekzistencën e tarifave të drejta kundrejt shpërblimit. Gjatë vitit 2018 do të fillojë të zbatohet një operacion kombëtar për dhënien fund të paligjshmërisë në fushën e ujit. Me këtë operacion, do të garantohet furnizim i pandërprerë me ujë për të gjithë popullsinë.

### **Reforma në drejtësi.**

Projektbuxheti financon të gjitha proceset që kanë objekt reformën në drejtësi, që nga krijimi i institucioneve të reja, deri tek investimet teknologjike në sistemin gjyqësor, duke ndihmuar në rritjen e transparencës dhe të shpejtësisë së shërbimit ndaj qytetarëve. Zbatimi i kësaj reforme do të ndihmojë në realizimin e disa objektivave në periudhën afatmesme, siç janë rritja e llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve, krijimi i precedentëve të hetimeve, ndjekjes penale dhe dënimeve në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, përmirësimi i mekanizmave institucionale lidhur me drejtësinë për të mitur, si dhe respektimin e të drejtave të pronësisë.

### **Reforma në administratën publike.**

Një ndër synimet e kësaj reforme është përcaktimi i nevojave financiare afatmesme në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës së Administratës Publike 2015-2020. Kjo strategji fokusohet mbi zhvillimin dhe zbatimin e procedurave transparente dhe të paanshme të rekrutimit, menaxhimin e burimeve njerëzore, zhvillimin e karrierës në shërbimin publik, trajnimin e vazhdueshëm, promovimin e etikës në administratën publike, si dhe garantimin e qeverisjes elektronike.

### **Reforma në menaxhimin e financave publike.**

Disa nga synimet kryesore të kësaj reforme janë forcimi i kapaciteteve të Institutit të Statistikave në fushën e llogarive kombëtare të qeverisë, rishikimi dhe përditësimi i SKZHI-së dhe strategjive sektoriale në procesin e PBA-së, miratimi i akteve nënligjore të ligjit “Për Financat Vendore”, ngritja e kadastrës fiskale, rishikimi i metodologjisë dhe udhëzimeve standarde për përgatitjen e PBA-së, forcimi i sistemit të rishikimit të Prokurimeve Publike etj. Në kuadër të hartimit të projektbuxhetit për vitin 2018, Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, me qëllim kryesor mirëmenaxhimin e fondeve publike, do të monitorojë në vazhdimësi veprimtarinë e institucioneve mbi bazë performance, si dhe do të zhvillojë në vijim kapacitetet e administratës publike.

### **Reforma administrativo-territoriale.**

Në kuadër të kësaj reforme, projektbuxheti parashikon rritjen e transfertës së pakushtëzuar, si dhe të të ardhurave nga burimet e veta vendore; reformimin e taksës së pronës; rritjen e totalit të fondeve për pushtetin vendor; uljen e kostove për qytetarët, përmirësimin e procesit të decentralizimit të financave publike; rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike; zhvillimin ekonomik lokal dhe uljen e pabarazive midis njësive të qeverisjes vendore etj.

### **Reforma në sektorin e turizmit.**

Sektori i turizmit do të mbështetet nga një paketë fiskale lehtësuese, e cila do të ndihmojë në promovimin e zhvillimit të tij. TVSH për këtë sektor do të vijojë të jetë 6 për qind. TVSH do të

jetë zero për 10 vjet nga nisja e punës për kompanitë që ndërtojnë hotele të reja me 4-5 yje. Do të rritet investimi në rrugët, të cilat nxisin zhvillimin turistik.

### **Reforma në infrastrukturë.**

Për vitin 2018 është parashikuar hapja e tri projekteve të reja, siç janë ndërtimi i Rrugës së Arbrit, Rrugës Thumanë-Vorë dhe Unazës së Madhe të Tiranës. Do të mbulohen tërësisht me financim dhe do të përfundojnë 10 segmente rrugore, si dhe do të mbulohen me financim të huaj 5 objekte. Mbështetje me financim do të ketë edhe për sinjalistikën dhe sigurinë rrugore. Paketa e investimeve prej 1 miliardë eurosh do të nisë nga zbatimi gjithashtu vitin e ardhshëm, me fokus të përqendruar tek infrastruktura.

**Gjithashtu, projektbuxheti parashikon vijimin e reformave të nisura edhe në sektorë të tjerë të ekonomisë,** siç janë reforma e pensioneve, reforma e kompensimit të pronarëve, reformat në fushën fiskale etj. Për rritjen e pensioneve është parashikuar një fond prej 1.8 miliardë lekësh. Për kompensimin e pronave është parashikuar një fond prej 4 miliardë lekësh, i cili do të rritet në vitet e ardhshme, duke arritur nivelin 5.5 miliardë lekë në vitin 2020. Në fushën fiskale parashikohet një projekt për përmirësimin e teknologjisë, në mënyrë që transaksionet midis biznesit dhe konsumatorëve të jenë online dhe të lidhura në kohë reale me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

### **Prioritetet në disa sektorë të tjerë të ekonomisë do të jenë si më poshtë:**

**Bujqësia** – Do të rritet financimi për sektorin e bujqësisë, agroindustrinë dhe kompanitë eksportuese. Njëkohësisht, pas mbylljes së suksesshme të negociatave me Komisionin Europian, do të rritet edhe financimi i skemave të financuara me fonde europiane.

**Kultura** – Buxheti i ri do të financojë fillimin e punës për Bibliotekën e Re Kombëtare, si dhe do të nisë puna për transformimin e Galerisë së Arteve dhe Muzeut Kombëtar.

### **Mbrojtja sociale.**

Pas energjisë, në paketën e ndihmës sociale do të përfshihet edhe pagesa për ujin e pijshëm. Buxheti do të mbështesë gjithashtu një përmirësim të përfitimeve për shtresat në nevojë.

**Shëndetësia** – Nga viti i ardhshëm do të nisë të zbatohet programi për rehabilitimin e të gjitha spitaleve rajonale të vendit. Do të mbështetet edhe shpronësimi i ndërtesave të legalizuara brenda perimetrave të qendrave spitalore, si në Fier, Elbasan, etj. Gjithashtu, një rritje të mëtejshme do të kenë pagat për mjekët, si dhe do të ketë një bonus të shtuar për të gjithë mjekët që pranojnë të punojnë larg vendbanimit të tyre.

### **9. Rritja e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit është prioritet i projektbuxhetit.**

Si rrjedhojë e rritjes ekonomike dhe e rritjes së formalizimit të ekonomisë, të ardhurat e përgjithshme të buxhetit për vitin 2018 parashikohen të jenë 26 miliardë lekë më të larta ose 6 pikë përqindje më shumë se buxheti i vitit 2017. Parashikohet që të ardhurat në buxhet të arrijnë nivelin 28 për qind të PBB-së. Kjo rritje e të ardhurave është tregues i përmirësimit të mbledhjes së tyre, në kuadër të reformës për konsolidimin e financave publike.

Peshën kryesore në rritjen e të ardhurave për vitin 2018 e kanë të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të cilat rriten me 18 miliardë lekë ose 6 pikë përqindje më shumë se viti 2017.

Paketa fiskale e vitit 2018 parashikon reduktimin e taksave për turizmin, teknologjinë e informacionit dhe sektorin e peshkimit. Rriten taksat për makinat e shtrenjta, si dhe mallrat e luksit, përfshirë cigaret.

#### **10. Rritja e shpenzimeve publike është bazë për rritjen e investimeve dhe të konsumit.**

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit në vitin 2018, parashikohet të jenë 27 miliardë lekë më shumë ose 6 pikë përqindje më të larta se një vit më parë. Ato përbëjnë 30.1 për qind të PBB.

Karakteristikë kryesore e shpenzimeve buxhetore është përmirësimi i cilësisë së tyre, si rezultat i rritjes më të përshpejtuar të shpenzimeve kapitale, krahasuar me shpenzimet korrente. Kështu, shpenzimet kapitale për vitin 2018 parashikohen të rriten me 16.2 pikë përqindje, ndërkohë që shpenzimet korrente rriten me 5.2 pikë përqindje.

#### **11. Projektbuxheti synon thellimin e procesit të decentralizimit dhe fuqizimin e njësive të vetëqeverisjes vendore.**

Buxheti vendor i viteve 2016-2017, në kuadër të reformës administrativo-territoriale, realizoi transferimin e një sërë funksionesh nga qeverisja qendrore, drejt asaj vendore. Projektbuxheti parashikon vijimin e konsolidimit të financave vendore, nëpërmjet rritjes së të ardhurave nga transferta e pakushtëzuar, mbështetjes me grantin specifik dhe rritjes së burimeve të financimit nga të ardhurat veta.

Buxheti i pushtetit vendor, në vitin 2018, parashikohet të rritet me 7.5 pikë përqindje në krahasim me vitin 2017, duke përbërë 2.8 për qind të PBB.

Transferta e pakushtëzuar, në vitin 2018, parashikohet të rritet me 3 miliardë lekë ose 17.5 pikë përqindje në krahasim me vitin e mëparshëm. Krahasuar me vitin 2013, transferta e pakushtëzuar është 36.6 për qind më e lartë. Formula e ndarjes së kësaj transferte është përmirësuar, për të realizuar funksionimin e mirë të njësive të qeverisjes vendore.

Granti specifik prej 7.4 miliardë lekësh, i cili është 0.7 miliardë lekë më i lartë se një vit më parë, do të përdoret për financimin e funksioneve të transferuara, si mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi, arsimit, rritja e pagave, administrimi i pyjeve dhe mirëmbajtja e kanaleve ujitëse e kulluese.

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, në vitin 2018, parashikohet të rriten me rreth 2 miliardë lekë krahasuar me një vit më parë. Kjo rritje do të vijë nga reformimi i tarifave të shërbimeve publike, ndarja më e drejtë dhe transparente e financave të njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i skemës së financimit të funksioneve të veta. Një ndikim të konsiderueshëm pozitiv në të ardhurat vendore ka ndryshimi i parashikuar në taksën e pronës dhe kadastrën fiskale.

Në vitin 2018 do të vazhdojë të monitorohet zbatimi i planit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura nga njësitet e qeverisjes vendore.

***Në përfundim***, deputetët e mazhorancës dhanë disa rekomandime mbi politikat kryesore që duhet të vijojnë të ndiqen gjatë vitit 2018 dhe periudhës afatmesme për të arritur objektivat e parashikuara në projektbuxhet; siç janë thellimi i reformave strukturore; përmirësimi i mbledhjes së të ardhurave; disiplinimi dhe rritja e cilësisë së shpenzimeve publike; si dhe monitorimi i risqeve fiskale, që mund të vijnë nga fatkeqësitë natyrore, kushtet e pafavorshme klimaterike, vendimet gjyqësore me karakter kombëtar e ndërkombëtar etj.

#### **IV.2. Vlerësimi i opozitës.**



Deputetët e opozitës e kundërshtuan projektbuxhetin në të gjitha aspektet dhe pjesët përbërëse të tij. Ata shprehën mosbesim për nivelin e parashikuar të rritjes ekonomike, për shkak të nivelit jo të mjaftueshëm të konsumit dhe investimeve publike. Rritja e të ardhurave është e ulët, edhe pse mbështetet në një paketë fiskale që rëndon biznesin e vogël dhe qytetarët. Ata ishin të mendimit se ka pamjaftueshmëri fondesh për politika të reja pagash e pensionesh, infrastrukturën vendore dhe të dënuarit politikë. Projektet koncesionare kanë kosto të lartë për buxhetin dhe mbartin risqe fiskale. Niveli i borxhit publik është i lartë.

#### **V. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve të tjera.**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat u njoh me raportet në parim të komisioneve të tjera të përhershme të Kuvendit për projektbuxhetin. Në këto raporte pasqyrohet vlerësimi pro i mazhorancës dhe vlerësimi kundër i opozitës për projektbuxhetin, si dhe jepen argumentet përkatëse. Në disa raporte paraqiten propozime për ndryshime në buxhetin e institucioneve të varësisë. Komisioni për Ekonominë dhe Financat do t'i shqyrtojë të gjitha propozimet e komisioneve të tjera gjatë fazës së shqyrtimit nën për nën të projektbuxhetit, për të arritur plotësimin e kërkesave brenda mundësive që ofron projektbuxheti.

#### **VI. Përfundim.**

Mbështetur në vlerësimet e mësipërme, Komisioni për Ekonominë dhe Financat e miratoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2018” me votat pro të mazhorancës dhe votat kundër të opozitës.

**RELATORI**

**Anastas ANGJELI**

**KRYETARI**

**Erion BRAÇE**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**Komisioni për Ekonominë dhe Financat**

Tiranë, më 27.11.2017

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

**R A P O R T**

**PËR VLERËSIMIN NEN PËR NEN DHE NË TËRËSI TË PROJEKTLIGJIT**

**“PËR BUXHETIN E VITIT 2018”**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 21, 22, 23 dhe 27 nëntor 2017, shqyrtoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2018”, propozuar nga Këshilli i Ministrave. Procedura e shqyrtimit të projektligjit u mbështet në nenet 32-39, 80 dhe 83 të Rregullores së Kuvendit.

Shqyrtimi nen për nen i projektbuxhetit u zhvillua pas miratimit në parim të tij, në seancën plenare të datës 16 nëntor 2017. Ai mori në konsideratë edhe projektligjet e paketës fiskale dhe ndryshimet përkatëse, të miratuara në Komision.

Komisioni zhvilloi disa seanca dëgjimore, respektivisht me Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; si dhe Ministrin e Bujqësis dhe Zhvillimit Rural, për t’u njohur më në detaj me investimet e parashikuara në projektbuxhet në këta sektorë të rëndësishëm të ekonomisë. Gjithashtu, Komisioni zhvilloi një seancë dëgjimore me Ministrin e Drejtësisë, për t’u njohur më në thellësi me projektbuxhetin e parashikuar për reformën në drejtësi.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat shqyrtoi raportet e komisioneve të tjera të përhershme të Kuvendit për vlerësimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2018”. Në këto raporte pasqyrohet se në secilin komision projektbuxheti është miratuar, nen për nen dhe në tërësi, me votat pro të mazhorancës. Disa komisione kanë propozuar ndryshime në shpenzimet e parashikuara për vitin 2018 për ministrinë dhe institucionet e varësisë së tyre, duke dhënë edhe argumentet mbështetëse.

Gjithashtu, pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat janë paraqitur disa propozime të argumentuara, për ndryshime në projektbuxhet, nga Byroja e Kuvendit, Kontrolli i Lartë i Shtetit etj.

Të gjitha propozimet e paraqitura u analizuan nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat, si dhe u konsultuan me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, për të parë mundësinë e mbulimit të tyre me burimet e nevojshme buxhetore.

Lidhur me propozimin e deputetit Edmond Spaho për realizimin e projekteve të Bashkisë Shkodër, Komisioni vlerësoi se nuk mund të kryente ndryshime në ligjin e buxhetit, por theksoi të nevojshme që, gjatë fazës së zbatimit, Këshilli i Ministrave ta ketë në vëmendje këtë shqetësim.

Në përfundim të këtij procesi, si dhe duke analizuar burimet e mundshme për të përballuar shtesën e shpenzimeve buxhetore, Komisioni miratoi një pjesë të propozimeve. Për propozimet e paplotësuara, Komisioni rekomandon përballimin e nevojave të domosdoshme nga fondi i parashikuar në projektbuxhet, duke rritur efektivitetin e përdorimit të fondeve në dispozicion.

Komisioni e miratoi projektligjin nen për nen dhe në tërësi me votat pro të mazhorancës dhe votat kundër të opozitës, duke propozuar disa shtesa e ndryshime në projektligj, si më poshtë:

**A) Në fund të nenit 19** shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Këshilli i Ministrave (Ministria e Financave dhe Ekonomisë) raporton në Komisionin për Ekonominë dhe Financat për çdo kontratë të re të koncesioneve dhe partneriteteve publike private, që nënshkruhet dhe i shtrin efektet brenda vitit buxhetor, në funksion të ruajtjes së tavanit për vlerën totale të kontratave në përqindje të prodhimit të brendshëm bruto”.

**B) Në tabelat dhe anekset** bashkëlidhur projektligjit bëhen këto ndryshime:

**I.** Në mbështetje të reformës në drejtësi dhe procesit të vettingut, bëhen disa ndryshime në institucionet e mëposhtme:

- 1. Kolegjit të Posaçëm të Apelimit** i shtohen shpenzimet për investime me 26 milionë lekë.
- 2. Komisionit të Pavarur të Kualifikimit** i shtohen shpenzimet për investime me 15 milionë lekë.
- 3. Komisionerëve Publikë** u shtohen shpenzimet për investime me 9 milionë lekë.
- 4. Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor** i shtohen 5 punonjës dhe 14 milionë lekë shpenzime.
- 5. Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive** i shtohen shpenzimet me 4 milionë lekë.
- 6. Shkollës së Magjistraturës** i shtohen 2 punonjës dhe 26 milionë lekë shpenzime.
- 7. Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave** i shtohen shpenzimet për investime me 7 milion lekë.
- 8. Gardës së Republikës** i shtohen 50 punonjës.

**II.** Bëhen disa ndryshime në disa institucione kryesore dhe të pavarura, si më poshtë:

1. **Presidencës** i shtohen shpenzimet me 30 milionë lekë për të mbështetur veprimtarinë e institucionit, si aktivitete ceremoniale dhe rinovim të sistemit të monitorimit me kamera sigurie.
2. **Kuvendit** i shtohen shpenzimet me 80 milionë lekë, për mbështetjen e aktivitetit parlamentar, si dhe përmirësimin e zgjerimin godinës.
3. **Kontrollit të Lartë të Shtetit** i shtohen 5 punonjës dhe 10 milionë lekë shpenzime personeli për mbështetjen e veprimtarisë audituese.
4. **Komisionerit për Shërbimin Civil** i shtohen shpenzimet me 3 milionë lekë (saktësim në fondin e pagave).
5. **Autoritetit të Konkurrencës** i shtohen 4 punonjës dhe 11 milionë lekë shpenzime.
6. **Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale** i shtohen 2 punonjës dhe 5 milionë lekë shpenzime.
7. **Arkivit të Shtetit** i shtohen shpenzimet me 45 milionë lekë.
8. **Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve** i shtohen shpenzimet me 300 milionë lekë.

**III.** Bëhen disa ndryshime në ministritë si më poshtë:

1. **Ministrisë së Drejtësisë** i shtohen 25 punonjës dhe 20 milionë lekë shpenzime.
2. **Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme** i shtohen shpenzimet me 35 milionë lekë, për projektin e regjistrimit të shtetasve jashtë vendit.
3. **Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë** i shtohen shpenzimet për investime me 270 milionë lekë dhe i reduktohen shpenzimet korrente në të njëjtën masë.
4. **Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit** i shtohen shpenzimet për investime me 100 milionë lekë.

**IV. Pushtetit vendor** i shtohen 70 milionë lekë transfertë e pakushtëzuar, e detajuar në njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas aneksit bashkëlidhur.

**V. Bëhen disa saktësime në tabelat e buxhetit,** si më poshtë:

- Në tabelën 1.2 të projektligjit:

- Grupi “63” bëhet "Institucione të mbikëqyrjes dhe rivlerësimit të sistemit të drejtësisë“;
- Grupi 87 programi “shërbime për diasporën” riemërtohet “Agjensia për Diasporën dhe Migracionin”.

- Në tabelën 4 të projektligjit bëhen këto ndryshime:

- Të ardhurat nga akciza pakësohen me 900 milionë lekë, ndërsa të ardhurat nga TVSH shtohen me 900 milionë lekë.
- Emërtimi “Buxheti lokal (Të ardhura nga transferimi i rentës)” zëvendësohet me emërtimin “Buxheti vendor (Të ardhura nga taksat e ndara)”. Kudo në këtë tabelë, fjala “lokal” zëvendësohet me fjalën “vendor”.

**VI.** Detajimi i ndryshimeve në shpenzimet e institucioneve, si më lart, si dhe burimet e mbulimit të tyre pasqyrohen në tabelën 1 bashkëlidhur.

**VII.** Ndryshimet e mësipërme të pasqyrohen në tabelat dhe nenet respektive të projektligjit.

### **Përfundim.**

Komisioni e miratoi, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin “Për buxhetin e vitit 2018” me votat pro të mazhorancës dhe votat kundër të opozitës, me ndryshimet e pasqyruara më lart.

**RELATORI**

**Anastas ANGJELI**

**KRYETARI**

**Erion BRAÇE**

<b>Aneksi 1</b>	
<b>Transferta e pakushtezuar per njesite e veteqeverisjes vendore</b>	
<b>Bashkite</b>	<b>Shtesa</b>
<b>Gramsh</b>	20
<b>Finiq</b>	10
<b>Patos</b>	10
<b>Lushnje</b>	10
<b>Divjake</b>	10
<b>Permet</b>	5
<b>Kavaje</b>	5
<b>Total</b>	<b>70</b>